

105/2/2021



dt - 15.01.2021

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E BRENDSHME  
SHËRBIMI PËR ÇËSHTJET E BRENDSHME DHE ANKESAT

URDHËR

Nr. 01/ Datë 15.01.2021  
PËR

MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR SINJALIZUESIN, HETIMIN  
ADMINISTRATIVE DHE MBROJTJEN E SINJALIZUESVE"

Bazuar në nenin 3 gërma "a", të Ligjit Nr.70/2014, "Për Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme, neni 7, pika "ë" e Rregullore së SHÇBA-së, miratuar me VKM nr.829, datë 03.12.2014 "Rregullore së Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat", neni 13 pika 10 e Ligjit Nr. 60/2016 "Për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve";

URDHËROJ:

1. Miratimin e Rregullore së Sinjalizimit, Hetimit Administrativ dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri pjesë e pandarë e tij.
2. Me njohjen dhe zbatimin e këtij urdhri ngarkohet të gjithë punonjësit e SHÇBA-së
3. Për kontrollin e zbatimit të këtij urdhri ngarkohet Njësia Përgjegjëse e Sinjalizimit në Drejtorin e Përgjithshme të SHÇBA-së.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.





---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E BRENDSHME  
SHËRBIMI PËR ÇËSHTJET E BRENDSHME DHE ANKESAT

**RREGULLORE**

**PËR**

**SINJALIZIMIN, HETIMIN ADMINISTRATIVE DHE MBROJTJEN E SINJALIZUESVE**

**MIRATUAR ME URDHËR TË DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË SHÇBA-SË NR.  
105/2 DATË 15.01.2021**

**Neni 1**  
**Baza ligjore**

Rregullorja për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, bazohet në ligjin nr. 60/2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, në Kodin e Procedurave Administrative, në VKM nr. 816 datë 16.11.2016, si dhe në akteve të tjera nënligjore të miratuara për këtë qëllim nga ILDKPKI-së.

**Neni 2**  
**Objekti**

Objekti i kësaj rregulloreje është zbatimi i ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, për përcaktimin e rregullave dhe procedurave të hetimit administrativ të sinjalizimit, si dhe detyrimet për mbrojtjen e sinjalizuesve,

**Neni 3**  
**Përkufizime sipas ligjit**

Në këtë Rregullore termat e më poshtëm kanë këto kuptime:

1. “I sinjalizuar” janë një ose më shumë persona, ndaj të cilëve bëhet një sinjalizim, sipas këtij ligji, në lidhje me një veprim ose praktikë të dyshuar korrupsioni.
2. “Njësia përgjegjëse” është organi i posaçëm, i caktuar në Drejtorinë e Përgjithshme të SHÇBA-së, e cila është ngarkuar me detyrën e shqyrtimit të hetimit administrativ të sinjalizimit dhe shqyrtimin e kërkesës për mbrojtjen e sinjalizuesit, sipas përcaktimeve të këtij ligji.  
Në SHÇBA, “Njësia përgjegjëse” përbehet nga dy punonjës të Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse, referuar pikës 3 të VKM nr. 816 datë 16.11.2016
3. “Sinjalizim” është raportimi i informacionit nga ana e sinjalizuesit tek njësia përgjegjëse për veprime apo praktika të dyshuara korrupsioni, të kryera në vendin e tij të punës apo dhe në struktura të tjera.
4. “Sinjalizues” është individi, i cili aplikon ose është në marrëdhënie pune, ose ka punuar më parë pranë strukturave të SHÇBA-së, pavarësisht nga natyra e marrëdhënies së punës ose kohëzgjatjes së saj, si dhe nëse paguhet ose jo, që sinjalizon një veprim ose praktikë të dyshuar korrupsioni.
5. “Veprim ose praktikë e dyshuar korrupsioni” është një veprim ose mosveprim, fakte ose rrethana të kryera në një organizatë, për të cilat sinjalizuesi dyshon në mirëbesim, sipas këtij ligji, se mund të përbejë korrupsion.

**Neni 4**  
**Parimet e veprimtarisë**

Njësia Përgjegjëse për zbatimin e ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, bazohet në parimin e:

- a. ruajtjes së konfidencialitetit të informacionit të sinjalizimit,

- b. njohjes së identitetit të sinjalizuesit, përveç rastit kur ligji lejon pranimin e një sinjalizimi anonim;
- c. sinjalizimit vullnetar të një veprimi ose praktike të dyshuar të korrupsionit;
- d. integritetit dhe paanshmërisë gjatë shqyrtimit të sinjalizimit;
- e. zbatimit të mekanizmave të efektshëm dhe të përshtatshëm për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave legjitimë të sinjalizuesit;
- f. procedurës së hetimit administrativ të sinjalizimit në mënyrë të shpejtë dhe të besueshme.

## **Neni 5**

### **Forma dhe përmbajtja e sinjalizimit**

1. Sinjalizimi bëhet me çdo mjet komunikimi, në formë të shkruar ose deklarohet verbalisht para punonjësit të caktuar të njësisë përgjegjëse dhe dokumentohet me shkrim.
2. Sinjalizimi përmban të paktën:
  - a. të dhënat e identitetit të sinjalizuesit;
  - b. të dhënat e kontaktit të sinjalizuesit;
  - c. përshkrimin e fakteve e të rrethanave të njohura nga sinjalizuesi për veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit, shoqëruar me provat përkatëse, për aq sa është e mundur;
  - d. referimin përkatës në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, për aq sa është e mundur, nga sinjalizuesi, të veprës ose praktikës së dyshuar të korrupsionit;
3. Sinjalizuesi mund të zgjedhë të mbetet anonim dhe sinjalizimi pranohet, vetëm nëse në të janë shprehur qartë dhe janë arsyetuar shkaqet e anonimatit dhe të dhënat e sinjalizuara sigurojnë një bazë të mjaftueshme për të hetuar administrativisht veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit.
4. Në rastet kur sinjalizimi nuk është depozituar sipas formës dhe përmbajtjes së mësipërme sinjalizuesit i kërkohet me shkrim të korrigjojë këto të meta brenda 7 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për korrigjim.

## **Neni 6**

### **Procedura e hetimit administrativ**

1. Njësia përgjegjëse heton drejtpërdrejt sinjalizimin për veprimet ose praktikën e dyshuara të korrupsionit në strukturat e SHÇBA-së.
2. Procedura e hetimit administrativ të sinjalizimit përfundon sa më shpejt të jetë e mundur, por, në çdo rast, jo më vonë se 60 ditë nga data e fillimit të hetimit, përveçse kur nga rrethanat kërkohet një afat më i gjatë.
3. Gjatë periudhës së hetimit administrativ, njësia përgjegjëse shqyrton dhe vlerëson pretendimet e ngritura nga sinjalizuesi në lidhje me veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit.
4. Njësia përgjegjëse ka të drejtë të kërkojë informacione dhe dokumente, të urdhërojë inspektive ose analiza, të mbledhë deklarata ose të pyesë persona në dijeni ose rrethanat e çështjes ose të konsultohet me ekspertë të fushave të ndryshme.
5. Në hetimin administrativ merr pjesë sinjalizuesi dhe çdo person tjetër i tretë, kur dyshohet se posedon dokumente ose ka dijeni për rrethanat e sinjalizuara, përfshirë dhe të sinjalizuarin,

- nëse vlerësohet e nevojshme nga drejtuesi i hetimit.
6. Çdo palë pjesëmarrëse në hetimin administrativ i garantohet një proces i rregullt, në përputhje me parashikimet në Kodin e Procedurave Administrative, si dhe :
    - a. mund të japë deklaratë me shkrim, argumente ose opinione,
    - b. mund të konsultohet me dosjen e hetimit,
    - c. ka të drejtë të dëgjohet në lidhje me pretendimet e tij.
  7. Njësia përgjegjëse njofton sinjalizuesin për çdo masë të marrë në përgjigje të sinjalizimit jo më vonë se 30 ditë nga momenti i kryerjes së veprimit. Pavarësisht nga afati i njoftimit të parashikuar në këtë nen, njësia përgjegjëse është e detyruar t'i përgjigjet brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës për informacion, të paraqitur me shkrim nga sinjalizuesi, në çdo kohë, në lidhje me çështjen e sinjalizuar prej tij.
  8. Nëse në përfundim të hetimit administrativ nga njësia përgjegjëse rezulton se veprimi ose praktika e dyshuar e sinjalizuar përbën ose mund të përbëjë një shkelje administrative, sipas ligjit, vihet në dijeni organin kompetent.
  9. Sinjalizimet regjistrohen në një regjistër të posaçëm protokolli dhe elektronik për regjistrimin e sinjalizimeve.

#### **Neni 7**

#### **Mosfillimi i hetimit administrativ**

Njësia përgjegjëse ka të drejtë të mos fillojë hetimin administrativ nëse;

1. sinjalizimi nuk është depozituar sipas formës dhe përmbajtjes së kërkuar dhe sinjalizuesi nuk korrigjon këto të meta brenda 7 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për korrigjim,
2. sinjalizimi përmban fakte dhe rrethana që nuk përfshihen në fushën e zbatimit të ligjit nr. 60/2016, sipas nenit 3, pika 6, të tij,
3. kur nga përmbajtja e sinjalizimit del haptazi se nuk ka elemente të kundërvajtjes administrative ose të veprës penale.

#### **Neni 8**

#### **Përfundimi i hetimit administrativ**

Njësia përgjegjëse ka të drejtë të përfundojë hetimin administrativ nëse:

- a) gjatë hetimit rezulton se sinjalizimi për veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit është i bazuar, në këtë rast, njësia përgjegjëse njofton menjëherë Drejtorin e Përgjithshëm të SHÇBA-së si dhe prokurorinë.
- b) sinjalizuesi nuk ka vepruar në kushtet e mirëbesimit, në zbatim të nenit 6 të këtij ligji.
- c) Në dosjen e sinjalizimit shënohen vendimi për mosfillimin ose përfundimin e hetimit administrativ, i arsyetuar për të gjitha shkaqet që kanë çuar në vendimmarrjen përkatëse, si dhe masat e marra në lidhje me sinjalizimin.

#### **Neni 9**

#### **Mbrojtja e të dhënave personale**

Të dhënat personale të individëve të përfshirë në hetimin administrativ përpunohen vetëm për qëllim të ligjit nr. 60/2016. Në çdo rast, përpunimi i të dhënave personale kryhet sipas parimeve dhe procedurave të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në rastet kur, në zbatimin e këtij ligji, konstatohet mosrespektim i legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, çështja i referohet Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

#### **Neni 10**

#### **Të drejtat dhe mbrojtja e sinjalizuesve**

1. Të drejtat dhe interesat e sinjalizuesve mbrohen në mënyrë të besueshme, të efektshme dhe të përshtatshme dhe garantohen sipas ligjit 60/2016.
2. Sinjalizuesi gëzon të drejtën e:
  - a. konfidencialitetit gjatë procesit të sinjalizimit, që përfshin, gjithashtu, mundësinë e sinjalizimit anonim të një veprimi ose praktike të dyshuar korrupsioni,
  - b. ruajtjen e konfidencialitetit të burimit të informacionit të sinjalizuesit;
  - c. mbrojtjes kundër hakmarrjes, si pezullimin apo shkarkimin nga puna, transferimin brenda ose jashtë organizatës, uljen në detyrë apo në pagë, si dhe forma të tjera të hakmarrjes në lidhje me punën.
3. Çdo akt i hakmarrjes ndaj sinjalizuesit është i pavlefshëm.
4. Nëse sinjalizuesi dëshiron të vendoset në një strukturë tjetër të organizatës, për të mbrojtur veten nga reagime armiqësore në mjedisin e tij të afërt të punës, organizata merr masat e arsyeshme dhe të përshtatshme për të lehtësuar një lëvizje të tillë.

#### **Neni 11**

#### **Raportimi për sinjalizimet e regjistruar**

1. Njësia përgjegjëse zbaton detyrat e ngarkuara nga ILDKPKI-ja për lehtësimin dhe zhvillimin e procesit të sinjalizimit, si dhe i paraqet ILDKPKI-së çdo vit, jo më vonë se data 15 janar e vitit pasardhës, raport me shkrim për sinjalizimet e regjistruara, mënyrat e ndjekura për hetimin administrativ të sinjalizimeve dhe mbrojtjen e sinjalizuesve.
2. Në këtë informacion përfshihen numri i rasteve të sinjalizuara, rezultatet e rasteve, shkalla e ndërgjegjësimit dhe besimit të mekanizmat e sinjalizimit nga publiku, koha e përcaktuar për shqyrtimin e rasteve, sipas formularëve bashkëlidhur:
  - Formulari për Sinjalizimin
  - Formulari për kërkesë për mbrojtje nga hakmarrja,
  - Regjistrin për Sinjalizimin,
  - Regjistrin të kërkesë për mbrojtjen e sinjalizuesit

#### **Neni 11**

#### **Njohja dhe zbatimi i rregullores**

1. Me këtë rregullore të njihen të gjithë punonjësit e SHÇBA-së.

Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë.